



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:423/26, Datë: 03.04.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 147 të mbajtur më 23.03.2026, mori:

V E N D I M

- I.** Rikreditohen programet e studimeve të Kolegjit AAB , për periudhën pesë (5) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2031):
 1. *Menaxhment, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 240 studentë për vit akademik.*
 2. *Marketing dhe Biznes, BA (180 ECTS) me kuotën maksimumi 200 studentë për vit akademik.*
- II.** Rikreditohet programi i studimeve i Kolegjit AAB, për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2026 – 30 shtator 2029):
 1. *Infermieri, BSc (180 ECTS) me kuotën maksimumi 280 studentë për vit akademik.*
- III.** Numri i studentëve aplikohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- IV.** Obligohet Kolegji AAB që deri më datë 30.09.2026 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- V.** Obligohet Kolegji AAB të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet me vendim vetëm nga KShC.
- VI.** Institucioni i Arsimit të Lartë mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji AAB brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Menaxhment, BA (180 ECTS)	Pranvera Dalloshi Fidan Qerimi Naim Ismaili
2.	Marketing dhe Biznes, BA (180 ECTS)	Shpresa Mehmeti Bajrami Vjollca Hasani Adelina Gashi Saranda Tafa
3.	Infermieri, BSc (180 ECTS)	Idriz Sopjani, Dhurata Ivziku, Fadil Sherifi Agreta Gashi

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Kolegjin AAB.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr.03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master (tutje Manualit), ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për këto programe dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; Menaxhment, BA (180 ECTS)**, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 16.01.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.
- Për programin e studimit; Marketing dhe Biznes, BA (180 ECTS)** vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 16.01.2026 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:
 - Plotësisht pesë (5) fusha të standardeve të akreditimit dhe
 - Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

3. Për programin e studimit; Infermieri, BSc (180 ECTS) vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më datë 15.01.2026, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush:

- Plotësisht një (1) fushë të standardeve të akreditimit dhe
- Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 147-të, të mbajtur më datë 23.03.2026, ka shqyrtuar dokumentacionin e Kolegjit AAB dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekipet e ekspertëve të cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit AAB;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,
- Cilësisë

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të

